



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1458/6 prot.

Datë 21.07.2025

V E N D I M
Nr. 923 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.07.2025 shqyrtoi ankesën me,

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC Store” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T”, me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).

Ankimues: “Sinteza Co” Sh.p.k, me NIPT K11324003F, me adresë: Rruga e Barrikadave, Qendra “Turdiu”, kati III/2, Tiranë, 1057.

Autoriteti Kontraktor: Albcontrol SH.A (ish A.N.T.A), me adresë: Aeroporti “Nënë Tereza”, Rinas.

Subjekte të Interesuara: “PC Store” Sh.p.k, me NIPT L01606034A dhe adresë: Rruga “e Dibrës”

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.12.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.”, me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 26.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Sinteza Co” sh.p.k	12,534,500 lekë	Kualifikuar
“Atom” sh.p.k	13.105.180 lekë	Kualifikuar
“Pc Store” sh.p.k	13,212,400 lekë	Kualifikuar
“XPERT SYSTEMS”sh.p.k	13,894,000 lekë	Skualifikuar
“BNT ELECTRONICS”sh.p.k	nuk ka të dhëna	
“NAOL” sh.p.k	nuk ka të dhëna	

II.4. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 10.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5120 dhe me nr. protokoll 685/2025, protokolluar me datë 11.03.2025, e operatorit ekonomik “Pc Store” sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Sinteza Co” sh.p.k, “Atom” sh.p.k në procedurën e sipër përmendur të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.685/1 prot, datë 11.03.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Sinteza Co” sh.p.k, “Atom” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik ndryshuar”, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.685/2 prot., datë 17.03.2025 dhe kundërshtime të ankesës nr.685/1, protokolluar me tonën me nr. 685/3 datë 18.03.2025.

II.8. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 878 prot., datë 28 .03.2025, protokolluar me tonën me nr. 685/5 prot., datë 01 .04.2025, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - ankimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC Store ” sh.p.k ku rezulton, se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu rezulton se vendimi i KSHA është i depozituar në sistemin elektronik, vendim i cili është protokolluar me nr. 686/6 datë 02.04.2025.

II.9. Me anë të shkresës datë 03.04.2025, protokolluar me tonën me nr.685/7 prot., dhe nr. 880/1 datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor, ka përcjellë kthim përgjigje të shkresës së dërguar

nga KPP, shkresë e cila mban nr.685/4prot., datë 26.03.2025 si dhe gjithashtu ka bashkëlidhur vendimin e KSHA-së.

II.10. Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresave me nr. 685 /8 prot., datë 11.04.2025, si dhe shkresës me nr. 685/9prot., datë 11.04.2025, i është drejtuar operatorëve ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k si dhe “Atom” sh.p.k, me lëndë “Kërkesë për informacion” lidhur kjo e fundit me evidentimin (markimin) e specifikimeve teknike.

II.11.Me shkresat protokolluar me tonën 685/10 prot., datë 14.04.2025 operatori ekonomik “Sinteza CO” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës së përmendur në pikën II.10 të këtij vendimi si dhe gjithashtu operatori ekonomik “Atom” shpk ka përcjellë shkresën protokolluar me tonën me nr.685/11prot., datë 16.04.2025, lidhur edhe kjo e fundit me kërkesën e sipërcituar në pikën II.10 të këtij vendimi.

II.12 Me vendimin nr. 669 /2025, datë14.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.”. me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).*
2. *Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorët ekonomik “Atom” shpk dhe “ Sinteza CO” SHPK.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.13 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 02.06.2025, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Sinteza Co” sh.p.k	12,534,500 lekë	skualifikuar
“Atom” sh.p.k	13.105.180 lekë	skualifikuar
“Pc Store” sh.p.k	13,212,400 lekë	Kualifikuar
“XPRT SYSTEMS”sh.p.k	13,894,000 lekë	Skualifikuar
“BNT ELECTRONICS”sh.p.k	nuk ka të dhëna	
“NAOL” sh.p.k	nuk ka të dhëna	

II.14. Në datën 05.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5389 dhe me nr. protokollit 1458/2025, protokolluar me datë 05.06.2025, e operatorit ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “PC Store sh.p.k në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.15. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1458/1 prot, datë 09.06.2025 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “PC Store” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.16 Në datë 11.06.2025 operatori ekonomik “PC Store” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar në përputhje me nenin 113 të LPP-së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1458/2 prot.

II.17. Me shkresën me nr. 1409/2 prot., datë 12.06.2025 me lëndë “Dërgim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1458/3 prot., datë 16.06.2025 autoriteti kontraktor “Albcontrol” sha ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK, “Vendim Për/mbi shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik SINTEZA Co”, me nr. 1409/1 prot, datë 12.06.2025 nga ku rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Sinteza Co” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e operatorit ekonomik ankimues njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht, KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 23.12.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.”, me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa TVSH), zhvilluar më datë 10.02.2025, nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 26.02.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Sinteza Co” sh.p.k	12,534,500 lekë	Kualifikuar
“Atom” sh.p.k	13.105.180 lekë	Kualifikuar
“Pc Store” sh.p.k	13,212,400 lekë	Kualifikuar
“XPRT SYSTEMS”sh.p.k	13,894,000 lekë	Skualifikuar
“BNT ELECTRONICS”sh.p.k	nuk ka të dhëna	
“NAOL” sh.p.k	nuk ka të dhëna	

III.1.3. Në datën 03.03.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraparak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.4. Në datën 10.03.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5120 dhe me nr. protokoli 685/2025, protokolluar me datë 11.03.2025, e operatorit ekonomik “Pc Store” sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Sinteza Co” sh.p.k, “Atom” sh.p.k në procedurën e sipër përmendur të prokurimit.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.685/1 prot, datë 11.03.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Sinteza Co” sh.p.k, “Atom” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik ndryshuar”, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr.685/2 prot., datë 17.03.2025 dhe kundërshtime të ankesës nr.685/1, protokolluar me tonën me nr. 685/3 datë 18.03.2025.

III.1.8. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 878 prot., datë 28 .03.2025, protokolluar me tonën me nr. 685/5 prot., datë 01 .04.2025, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion lidhur me procedurën objekt - ankimi, vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC Store ” sh.p.k ku rezulton, se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Gjithashtu rezulton se vendimi i KSHA është i depozituar në sistemin elektronik, vendim i cili është protokolluar me nr. 686/6 datë 02.04.2025.

III.1.9. Me anë të shkresës datë 03.04.2025, protokolluar me tonën me nr.685/7 prot., dhe nr. 880/1 datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor, ka përcjellë kthim përgjigje të shkresës së dërguar nga KPP, shkresë e cila mban nr.685/4prot., datë 26.03.2025 si dhe gjithashtu ka bashkëlidhur vendimin e KSHA-së.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresave me nr. 685 /8 prot., datë 11.04.2025, si dhe shkresës me nr. 685/9prot., datë 11.04.2025, i është drejtuar operatorëve ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k si dhe “Atom” sh.p.k, me lëndë “Kërkesë për informacion” lidhur kjo e fundit me evidentimin (markimin) e specifikimeve teknike.

II.1.11.Me shkresat protokolluar me tonën 685/10 prot., datë 14.04.2025 operatori ekonomik “Sinteza CO” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës së përmendur në pikën II.10 të këtij vendimi si dhe gjithashtu operatori ekonomik “Atom” shpk ka përcjellë shkresën protokolluar me tonën me nr.685/11prot., datë 16.04.2025, lidhur edhe kjo e fundit me kërkesën e sipërcituar në pikën II.10 të këtij vendimi.

III.1.12 Me vendimin nr. **669/2025**, datë14.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.”. me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).*
2. *Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorët ekonomik “Atom” shpk dhe “ Sinteza CO” SHPK.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Pc Store” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.13 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 02.06.2025, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Sinteza Co” sh.p.k	12,534,500 lekë	skualifikuar
“Atom” sh.p.k	13.105.180 lekë	skualifikuar

“Pc Store” sh.p.k	13,212,400 lekë	Kualifikuar
“XPRT SYSTEMS”sh.p.k	13,894,000 lekë	Skualifikuar
“BNT ELECTRONICS”sh.p.k	nuk ka të dhëna	
“NAOL” sh.p.k	nuk ka të dhëna	

III.1.14. Në datën 05.06.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik 2025/5389 dhe me nr. protokoli 1458/2025, protokolluar me datë 05.06.2025, e operatorit ekonomik “Sinteza Co” sh.p.k, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “PC Store sh.p.k në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

III.1.15. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1458/1 prot, datë 09.06.2025 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “PC Store” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.16 Në datë 11.06.2025 operatori ekonomik “PC Store” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar në përputhje me nenin 113 të LPP-së protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1458/2 prot.

III.1.17. Me shkresën me nr. 1409/2 prot., datë 12.06.2025 me lëndë “Dërgim vendimi”, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1458/3 prot., datë 16.06.2025 autoriteti kontraktor “Albcontrol” sha ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK, “Vendim Për/mbi shqyrtimin e ankesës të operatorit ekonomik SINTEZA Co”, me nr. 1409/1 prot, datë 12.06.2025 nga ku rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës.

III.1.18. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.*

III.1.19. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i*

ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.20. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.21. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit. 2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës)”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. “4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

Neni 118, pika 1 dhe 2 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit. 2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”.

III.1.22. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, u konstatua se nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në datë 02.06.2025 autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e ofertave në SPE, por ende nuk ka publikuar Njoftim Fituesi. KPP vëren se operatori ekonomik ankimues “Sinteza Co” SHPK ka dorëzuar ankimin elektronik në sistemin elektronik të ankesave në datë 05.06.2025, ku kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin ofertës së operatorit ekonomik “Pc Store” SHPK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, pasi nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar ende njoftimi i Fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi, në momentin e dorëzimit të ankesës nga operatori ekonomik “Sinteza Co” SHPK. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, nis ditën e publikimit të njoftimit të Fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të

Prokurimit Publik në momentin e paraqitjes së ankesës në datë 05.06.2025, nuk kishte filluar akoma për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i Fituesit të procedurës së prokurimit, kjo e lidhur specifikisht me këtë procedurë prokurimi, pasi nga shqyrtimi i ofertave të dorëzuara nuk ka rezultuar asnjë ofertë e kualifikuar. Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, nga operatori ekonomik ankimues “Sinteza Co” SHPK në datë 05.06.2025, do të konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Sinteza Co” SHPK, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sinteza Co” SHPK për procedurën e prokurimit në procedurën e prokurimit “E hapur ” me Nr. REF-34263-12-20-2024, me objekt: “Blerje pajisje elektronike dhe e infrastrukturës I.T.”. me fond limit 14,299,467.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 10-02-2025 nga autoriteti kontraktor, ALBCONTROL SH.A (ish A.N.T.A).
2. Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sinteza Co” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

